

KOLEC TOPALLI

GJURMIME ETIMOLOGJIKE NË FJALORIN ARBËRESH

Arbërishtja e Italisë përbën një arkipelag gjuhësor, që është shkëputur valë-valë nga trangu i gjuhës-nënë para më shumë se pesë shekujsh. Duke mos qenë në kontakt me atdheun e lashtë dhe duke mos marrë pjesë në ndryshimet e shqipes, arbërishtja ka ruajtur fjalë e shprehje, forma gramatikore e struktura sintaksore, që i ka pasur dikur gjuha shqipe para emigrimit të arbëreshëve, por kanë ardhur duke humbur në shekujt e mëvonshëm. Njëkohësisht, duke jetuar në një mjedis tjetër, në rrymë të zhvillimit të brendshëm gjuhësor, ajo ka krijuar shumë fjalë të reja duke pasur si mbështetje brumin e gjuhës amtare. Në vijim po analizojmë disa prej tyre.

Emrin *gëlthatër* e ka Variboba te “Gjella e Shën Mëris Virgjër”, në vargjet “*Qenëria nëng’ do jatër / mose mish’ ndër gëlthatër*”¹, me përkthimin italisht “*La canaglia non vuole altro / che carne fra gli artigli*”. Nga ky autor e ka marrë Giordano, që e ka pasqyruar në fjalorin e tij të arbëreshëve të Italisë², duke e shpjeguar me “artiglio, unghia”, domethënë “çapok, kthetër, thua”. Fjala pasqyrohet edhe në Fjalorin Arbërisht-Shqip të Kolë Kamsit, ku *gëlthatër* shpjegohet me emrin “hell”³.

Duke hulumtuar nëpër fjalorët etimologjikë të gjuhës shqipe, këtë emër nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjërin prej tyre: mungon në Fjalorin etimologjik të Gustav Meyerit; mungon gjithashtu në studimet etimologjike të Çabejt dhe në Fjalorin etimologjik të Vladimir Orelit. Mbetet një fjalë e patrajtuar në studimet tona etimologjike.

Duke u nisur nga kuptimi i fjalës, ky emër lidhet përbrenda gjuhës me emrin *thadër*, që është “një lloj sqepari i ngushtë e me dy presa”. Me këtë lidhje, emri përfaqëson një fjalë të prejardhur, që analizohet në parashitesën *gël-dhe* emrin *thadër*. Forma *gëlthatër* përkundrejt *thadër* paraqet shurdhimin e bashkëtingëllores dhëmbore, si një dukuri asimilimi nga bashkëtingëllorja ndër dhëmbore. Rrënja e fjalës është e njohur edhe në shqipen e përkëtej Adriatikut dhe ka burim të trashëguar nga rrënja ie. *ses-* “pres” duke u krahasuar me ind. vj. *çāsati* “pret”, *çastrá-* “vegël për të prerë, thikë”, gr. *κεάζω* “çaj”, lat. *castro-āre* “pres”⁴. Forma e sotme *thadër* vjen nga *thadrë*, si

¹ Variboba Maria 4355-4356.

² Giordano Fj. 129.

³ Kamsi Fj. 83.

⁴ Jokl LKU 157 v., Çabej SF 3, 1966, 51.

të gjithë emrat e tjerë me këtë përbërje, të gjinisë femërore e mashkullore, si p.sh.: *mjeshtër* nga *mjeshtërë*, *kodër* nga *kodrë* etj. Këto forma janë ruajtur deri vonë në gjuhën shqipe, duke u shfaqur me trajtën e tyre të hershme tek autorët e vjetër; p.sh., te Buzuku: *Mëria muor një litrë unguent të pāçmuom* (LVI b = LXVI b), *eme motrë muo më lëshoi vetëmë* (LXXXVIII/2b = LXXXVIII/2b); Matrënga: *Mjeshtërë: -Jē ti i krēshtē?* (dsh I 8). Parashtesa *gël-*, që ka ky emër, është një variant i parashtesës *gë-* me shtimin e lëngëzores ose me bashkim parashtesash dhe përdoret për formim emrash nga tema emërore, si p.sh. *gëlvozhgë* e *gëlvojkë*, ose për formim foljesh nga tema foljore, si te *gëlçoj* nga folja *çoj*⁵.

Një lidhje tjetër e fjalës *gëlthadër* është me emrin *kthetër*, që përmban rrënjën *thadër*, por në numrin shumës me metafoninë /a/ > /e/, në pajtim me kuptimin e fjalës, që përdoret më tepër në këtë numër. Kështu, *gëlthatër* e *kthetër* ndryshojnë nga njëra-tjetra në zanoren e brendshme dhe në parashtesat që kanë marrë. Me këtë grup fjalësh lidhet edhe një fjalë tjetër e arbërishtes së Italisë, emri *gërthat-i*, që ka Fjalori i Giordanos për “artiglio” (“çapok, kthetër”). Forma e shumësit të këtij emri del me metafoini, *gërthetë*, ashtu si *kthetër*, që është një shumës i tillë. Kështu dalin tri fjalë me kuptime të njëjta por me forma të ndryshme: *kthetër*, *gërthat* me shumësin *gërthetë* dhe *gëlthatër*, që kanë marrë parashtesa të ndryshme në ballë të tyre.

Një fjalë tjetër, që e kanë vetëm arbëreshët, është *jetull* me kuptimin “shirit për të lidhur flokët, kordele”. E ka De Rada te “Këngët e Milosaos”: *me këshén të pjeksurith, ndë një jetullëz të bardhë*, ku emri ka marrë prapashtesë zvogëluese. Mitkoja e shënon si italianizëm. Giordano e ka me trajtën *hjetull* me grupin *hj-*, karakteristik i të folmeve arbëreshe, i cili në disa fjalë mund të jetë për *-ff-*; si te *hjivull* nga it. *fievole*. Në rrethana të tilla, *hjetull* është formim me prapashtesën *-ull* nga it. *fetta* me kuptimin “rrypinë”, që del edhe në it. *fettuccia* “shirit, kordele”. Sipas këtij burimi, më e lashtë është *hjetull*, më e re *jetull*, me rënie të e *h-së*. Arbëreshët kanë edhe foljet *hjetullonj* e *jetullonj* “lidh me kordele flokët”.

Një fjalë tjetër e arbërishtes së Italisë është folja *gëlmonj*, që del në Fjalorin e Giordanos⁶, ku folja është marrë nga Frasnita dhe ka kuptimin “shpoj, ther, kruaj”, it. “pungere, prurire”, p.sh.: *më gëlmon këmisha* “mi punge la camicia”. Me këtë rrënjë lidhen: mbiemri *gëlmor-e*, që jepet në këtë Fjalor për “therës”, it. “pungente” dhe emri *gëlmor-i* me shumësin *gëlmorë* që jepet për “hosten, thimth, thumb”, it. *pungolo, acúleo*. Folja nuk është trajtuar në fjalorët etimologjikë të shqipes dhe në studimet e tjera të kësaj fushe, prandaj mungon te Meyeri, Çabej e Orel, si rrjedhim, mbetet e pastudiuar.

⁵ Xhuvani-Çabej BUST SSS 4, 1956, 72.

⁶ Giordano Fj. 129.

Duke u nisur nga kuptimi leksikor i foljes, ajo paraqet një formim me prapashtesën *-o* nga rrënja *glemb*, që është forma e lashtë e emrit *gjemb*, ku është ruajtur grupi bashkëtingëllor i përbërë nga një grykore e një lëngëzore. Këtë formë të hershme ku është ruajtur lëngëzorja, e gjejmë në të folmen çame, që ka *glëmp*, *glimp*, nga të cilat është krijuar edhe folja *glëmbohem* “qukem nga gjambat”⁷, një formim paralel me arbërishten *gëlmonj*, që të dyja nga e njëjta rrënjë dhe me të njëjtën prapashtesë. Te *gëlmonj* përkundrejt emrit *glëmb*, lëngëzorja ka lëvizur në drejtim të fundit të fjalës duke u vendosur në kufirin e rrokjes së patheksuar, një dukuri e njohur e lëngëzoreve të gjuhës shqipe, që dëshmohet edhe në raste të tjera, si p.sh.: në formën e shumësit *pëlfej* nga njëjësi *plaf* “velenxë”, te foljet *pëlcas* nga *plas* e *këlthas* nga *klith*, në huazimin *pëlqej* nga lat. *placeo, -ere*, në toponimin *Kelmend* në Veri, që lidhet me patronimin *Clementi*; në Jug, në toponimin *Këlcyrë* nga gr. re κλεισῶρα etj.⁸.

Një fjalë tjetër që lidhet me këtë rrënjë është *gëlpenje*, që Giordano e përkthen me it. *serpenti* “gjarprinj”: *me gëlpenje të mundashtë* “con serpenti di seta”. Është shumësi me formantin *-enj*, si *lumë* ~ *lumenj*, nga rrënja *glep-*, prej së cilës është formuar *gjemb*, i përligjur kuptimisht nga pickimi i gjarprit.

Një fjalë tjetër arbëreshe që meriton vëmendje në planin etimologjik, është *ndovorria*, që e jep Giordano në Fjalorin e tij për lidhëzën “megjithëse” e ndajfoljen “ndoshta” me përkthimin italisht “benchè, forse”⁹. Në Fjalor, te lema *rrjet-i* jepet edhe një shembull me përdorimin e saj si lidhëz: *ndo se binje ndër rrjetin tim, qëndronje idhka e gjallë, ndovorria se pak je nderme*, me përkthimin italisht “se cadessi nella mia rete, rimarresti ancor viva, benchè poco onorata”. Këtë shembull autori e ka marrë prej dramës “Emira” të Anton Santorit. Një shembull tjetër me këtë fjalë, gjithnjë nga Santori, pati mirësinë të na e shërbejë studiuesi arbëresh Vincenzo Belmonte, i cili shënon se e ka gjetur atë në veprën e pabotuar “Leukotea” në faqet 178-179: “*Vemi, po ndovorria / na prikullin e shkuamë*”, ku *ndovorria* ka kuptimin “megjithatë”.

Fjala është një krijim në ngërthim të fjalisë, e formuar nga ngjizja e një protase të një periudhe hipotetike, *ndo rri* “ndonëse rri”, duke ndërhyrë elementi *vo*, që në origjinë përfaqëson pjesëzën thirrëse *o* dhe bashkëtingëlloren *-v-* për zhdukje të hiatit, që del shpesh në të folmet arbëreshe në pozicione të ndryshme, ndërmjet dy fjalëve ose në trup të tyre, si p.sh., te Camarda: *Do t'e thoshëja vash e re-vo*¹⁰; te Filja: *Sa vo janë faqet e shejtës Triadhë*¹¹; *tri-vo milë e tet qind*¹²; te Marchianò: *me liot të sijvovet*¹³.

⁷ Haxhihasani DS II 1974, 49.

⁸ Topalli Fon. 403.

⁹ Giordano Fj. 306.

¹⁰ Camarda Gr. 130.

¹¹ Figlia KA 15.

¹² Figlia CC E III 88.

Zanorja *-a*, që del në fund të fjalës, është prapashtesë me origjinë nga nyja shquese e gjinisë femërore, që e marrin përgjithësisht ndajfoljet, si: *para*, *mbrenda*, *prapa* etj.

E njëjtë për nga formimi me këtë, por pa ndërhyrjen e elementit epentetik *vo* në trup të fjalës, është lidhëza tjetër e këtij dialekti *ndorrina* me kuptimin e lidhëzës “ndonëse”, të cilën e shënon Gustav Meyeri në Fjalorin e tij Etimologjik si ndajfolje nga Kalabria me kuptimin “megjithatë”¹⁴, por pa shpjeguar formimin e saj. Shpjegimin e saj e ka dhënë Çabej në studimet e tij etimologjike, ku sheh me të drejtë një formim fjalësh nga leksikalizimi i një fjalie, *ndo rri* “ndonëse rri”¹⁵.

Emrin *citezë* e shënon Giordano për “laureshë”, lat. *Alauda cristata*, fjalë e Shën Sofisë së Kalabrisë. Është formim i brendshëm me formantin *-e* të emrave femërorë dhe prapashtesë zvogëluese nga një rrënjë me burim onomatopeik, imitim i zërit të këtij zogu. Nga kjo rrënjë është formuar folja *cijjat* “nxjerr një zë të hollë, pingëron (për minjtë dhe zogitë jo këngëtarë)”, që ka marrë prapashtesën *-at* dhe bashkëtingëlloren *-j-* për zhdukje të hiatit, fjalë kryesisht e gegërishtes, e njohur edhe në toskërishte, në Gjirokastrë.

Mbiemrin *cimblor* e shënon Giordano prej Bilottës me kuptimin “pungente, stimolante, frizzante”, domethënë “therës, nxitës”: *keq më mëshojën të thënat e atyre fjalëve cimblorë*. Është formim i brendshëm me prapashtesat *-lë + -or* nga *cimb* “pickoj, thumboj”, që lidhet përbrenda shqipes me *thimth* e *thimc* “thumbi i arzës a i bletës” me ndërrimin *c-* : *th-*, më tej me *cëmat* e *thumat* “pykë e vogël” e me një tjetër shkallë vokalike me *thumb*, që afrohet me rrënjën ie. *som-* “shtagë”, ku bën pjesë ind. vj. *çamyā* “shkop, hell, gozhdë druri, kunj”, gr. κάμαζ “shtagë, hu”.

Emrin *çitanik* e shënon Giordano prej Bilottës me kuptimin “anë, shirit zbukurimi që vihet në fund të fustanit”. Është formim i brendshëm me prapashtesën *-anik* prej *citë* “shtizë çorapësh e trikosh, pykë e hollë për të çarë dru”, fjalë e tosk. jug. dhe e nëndialektit çam me burim prej gr. së re τσίτα “kapsë, karficë, dantelë”¹⁶.

Foljen *grah* e ka mbarë shqipja me kuptimin “nxis një kafshë që të ecë, i bërtas, i thërras”, por kuptimin më të lashtë “thërras, ulurij” e kanë arbëreshët e Italisë: *grahu Turku si i tërbuam*, në fjalorin e Kolë Kamsit; *grahmë* “britmë”. Edhe Bogdani, ku fjala dëshmohet së pari, e ka me kuptimin “thërras”: *E Zotynë prej Sionit ka me grahunë* “Et Dominus de Sion rugiet”. Duke u nisur prej kuptimit “thërras”, që e ka ruajtur arbërishtja, folja është e trashëguar, e

¹³ Marchianò Canti 54.

¹⁴ Meyer EW 301.

¹⁵ Çabej SE I 97, SE VI 35.

¹⁶ Çabej SE III 49.

afërt me skt. *grnBti* “thërras”, lit. *giriù, girti* “lavdëroj, mburr”. Çabej e lidh me *ngreh* e *ngreë*¹⁷.

Të gjitha këto fjalë që u analizuan nga ana etimologjike, janë formime në truallin arbëresh. Por shumicën e elementeve përbërëse me të cilat janë krijuar, i ka mbarë shqipja, duke qenë të trashëguara nga gjuha indoeuropiane.

BIBLIOGRAFI

- Camarda, D., *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*. Livorno, 1864.
- Çabej, E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Tiranë, I 1982, III 1987, IV 1996, VI 2002.
- Çabej, E., *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, I-XXVIII*. BUST SSS 4, 1960 - 4, 1963; SF 1, 1964 - 3, 1968.
- De Rada, G., *Poesie albanesi del secolo XV. Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari*. Napoli, 1836.
- Demiraj, B., *Albanische Etymologien*. Amsterdam, 1997.
- Figlia, N., *I krishteu i arbresh*; në Marchianò Michele, *Il cristiano albanese*. Roma, 1911.
- Figlia, N., *Il Codice Chieutino*. A cura di Matteo Mandalà. Palermo, 1995.
- Giordano, E., *Fjalor i arbëreshëve t'Italisë*. Bari, 1963.
- Haxhihasani, Q., *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*. DS I 1971, II 1974.
- Jokl, N., *Linguistisch - kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*. Berlin und Leipzig, 1923.
- Kamsi, K., *Fjalor arbërisht - shqip*. Shkodër, 2000.
- Mann, S. E., *An Indo-European comparative dictionary*. Hamburg, 1984-87 (ICD).
- Marchianò, M., *Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia*. Foggia, 1908.
- Meyer, G., *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Strassburg, 1891.
- Orel, V. E., *Albanian Etymological Dictionary*. Leiden, 1998.
- Topalli, K., *Fonetika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 2007.
- Variboba, G., *Gjella e Sh. Mëris Virgjër*. Roma, 1762.
- Variboba, G., *La vita di Maria*. A cura di Italo Costante Fortino. Cosenza, 1984 (Maria).
- Xhuvani, A. - Çabej, E., *Parashtesat e gjuhës shqipe*. BSS 4, 1956.

¹⁷ Camarda I 152, Meyer EW 128, Mann ICD 342, Çabej SE IV 281, Orel AED 121.

SUMMARY

ARBËRESH WORLD IN ALBANIAN ETYMOLOGICAL STUDIES

The Arbëresh dialect of Italy constitutes a linguistic archipelago of particular interest to etymology. In this dialect are preserved many words that have lost in their old homeland. New words has been also created, with great interest for the etymology. The name *thadër* is inherited from the root of IE. *śes-* by comparing with Old Ind. *çásati, çastrá-*, Gr. *κεάζω*, Lat. *castro-āre*. The name *jetull* has De Rada, while Giordano has *hjetull*. Therefore *jetull* comes from *hjetull* and this from it. *fetta* with the suffix *-ull*. The verb *gëlmonj* is an internal formation from the name *glemb* with the suffix *-o*. With this word is related *gëlpenje*, a plural form with the suffix *-enj* as *lumë ~ lumenj*. The conjunction *ndovorria* is a creation within the sentence in a hypothetical period (*ndo-vorri*), where *vo* is an interfering element with the particle *o* and the consonant *-v-* for the disappearance of hiatus. The name *ciezë*, Lat. *Alauda cristata*, is an internal formation from an onomatopoeic root. Other similar internal formations are *cimblor* formed from the root *cimb* and the suffixes *-lë + -or*; *citanik* from *citë* with the suffix *-anik*; whereas *grah* is an inherited verb, close to Skt. *grnBti* “call”, lit. *giriù, girti* “praise”.